

Fleta e të dhënave të produktit
Botimi 26/11/2014 (v1)
Kodi: 11.02.030
Numri i identifikimit: 010301010010000177
SikaTop®-10

SikaTop®-10

Prajmer me bazë ujore dhe me materiale mbushëse minerale

Përshkrimi i produktit

SikaTop®-10 është një prajmer prej rrëshire sintetike, me bazë kopolimeresh stireni dhe akrilikësh, me materiale mbushëse minerale që përdoret si vulosës i poreve dhe përforcues i ngjitjes mbi nënshtresat e vjetra minerale, çimentoje dhe qeramike.

Fusha e përdorimit

SikaTop®-10 është i përshtatshëm për aplikimet e mëposhtme:

- Vulosje të nënshtresave minerale poroze
- Përmirëson ngjitjen e llaçeve mbi nënshtresat poroze
- I jep nënshtresës një strukturë të ashpër për përforcimin e ngjitjes fiziko-kimike të shtresave në vijim
- Veçanërisht i përshtatshëm si prajmer para aplikimit të llaçeve të nivelimit dhe dekorimit nga seria SikaDecor® Nature.

Veti / Avantazhe

- Vulosje efektive e porozitetit të nënshtresave të betonit
- Ekonomike
- Shmang humbjen e ujit të llaçeve nëpërmjet nënshtresës, krijimin e flluskave mbi sipërfaqen e tyre dhe përmirëson ngjitjen mbi nënshtresë.
- Shton padepërtueshmërinë e të gjithë sistemit të aplikimit
- Shton rezistencën e të gjithë sistemit të aplikimit
- Rezistent ndaj pH alkalik të nënshtresës
- Lehtëson procedurën e aplikimit të produkteve me natyrë hidraulike si shtresa të rradhës
- Mundëson aplikimin në nënshtresa betoni të parafabrikuar ose betonit me thithje të ulët

Vetitë e produktit

Paraqitja / Ngjyra Lëng, i kuq me elemente mbushëse

Ambalazhimi Bidona plastikë 5 dhe 20 kg

Magazinimi

Kushtet e Magazinimit/ Jetëgjatësia 12 muaj nga data e prodhimit, i magazinuar në ambalazhin fillestar, të mbyllur dhe të vulosur, në kushte të thata dhe në temperatura midis +5°C dhe +25°C. Mbrojeni nga ngrirja.

Vetitë teknike

Baza kimike Kopolimere stireni-akrilikësh me materiale mbushëse minerale

Dendësia ~1,32 kg/l (në +20°C)

Viskoziteti ~ 13770 mPa.s (në 20°C, Brookfield S64, 20 rpm)



Informacione mbi sistemin

Detaje aplikimi

Konsumimi	~ 0,8 kg /m ² Disa nënshtresa mund të kërkojnë konsumin më të madh material. Konsumimi është teorik dhe nuk përlogarit cilëndo sasi shtesë produkti që kërkohet nga poroziteti i sipërfaqes, profili i sipërfaqes, nivelimi, firon e materialit etj.
Cilësia e nënshtresës	Nënshtresa duhet të jetë e pastër dhe pa asnjë papastërti si vajrat, substanca të yndyrshme, bojëra dhe materiale pjekurimi sipërfaqësor etj. Nënshtresa mund të jetë e thatë ose pak e njomë, por në asnjë mënyrë me ujëra të mbledhur pellg mbi të.
Përgatitja e nënshtresës	Nënshtresa duhet të përgatitet mekanikisht (psh. me ujë me presion ose goditje me rërë) Largoni plohtësisht pluhurin, grimcat e lira dhe materialet me ngjitje të dobët përpara aplikimit të prajmerit, mundësisht me fshesë thithëse.

Kushtet e aplikimit / Kufizime

Temperatura e nënshtresës	+10°C minimale / +30°C maksimale
Temperatura e ambientit	+10°C minimale / +30°C maksimale
Udhëzime aplikimi	SikaTop®-10 është gati për përdorim. Përziheni produktin mirë para aplikimit duke tundur bidonin për të paktën 1 minutë.
Metoda e aplikimit / Mjetet	Produkti aplikohet me furçë ose rul që të sigurohet depërtimi i tij në nënshtresë.
Mirëmbajtja e mjeteve	Largimi i mbetjeve të freskëta nga mjete dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë. Materiali i ngurtësuar dhe/ose i pjekuruar mund të hiqet vetëm mekanikisht.
Koha e pritjes / Mbulimi	Pas aplikimit të prajmerit, duhet të thahet për të paktën 1 orë ose dhe më shumë në rast të kushteve me temperatura të ulëta ose me lagështi relative të lartë. Koha është me përafërsi dhe ndikohet nga kushtet klimaterike mbizotëruese dhe sidomos nga temperatura dhe lagështia relative.
Shënime aplikimi/ Kufizime	Në raste aplikimi gjatë muajve të verës (me temperatura mbizotëruese > +25°C), ruajeni SikaTop®-10 në ambient të freskët para aplikimit. Në raste aplikimi gjatë temperaturave të ulëta (<+15°C) produkti mund të bëhet më viskoz dhe të ulet punueshmëria e tij. Mos aplikoni produktin kur është i ngrirë. Në rast dyshimi, rekomandohet aplikimi në një zonë prove.

Baza e vlerave të matshme

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Kufizime lokale

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për përshkrimin e saktë të fushave të aplikimit.

Informacione mbi shëndetin dhe sigurinë

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit të sigurt, maganizimit dhe asgjësimit të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen botimit më të fundit të fletës me të dhënat e sigurisë (Safety Data Sheet, SDS), e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike, etj. rreth sigurisë gjatë përdorimit të produktit.

Shënime ligjore

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të SIKA-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e SIKA-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj formë tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. SIKA ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas të gjitha kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit.



Sika Albania SHPK
Rruga Ibrahim Rugova,
Sky Tower, Building no. 5,
9th floor, Office 91,
Tirana, Albania.

Tel.: +355 4 454 0070
Email: info@al.sika.com
alb.sika.com